

1

U zhvilluan **5 sesione trajnuese** me gra në Bashkinë Shkodër, në njësitë administrative Rrethina, Dajç, Postribë dhe Guri i Zi, me pjesëmarrje aktive të **100 grave** nga zona urbane dhe rurale.

Gjatë sesioneve u evidentuan **çështje prioritare**, si funksionimi jo i mirë i transportit publik, mungesa e çerdheve dhe kopshteve, problematikat me ndriçimin publik, kanalizimet, furnizimin me ujë të pijshëm dhe aksesin në shërbime publike.

P3

Raporti Watchdog 2024-2025

Rekomandime praktike:

Vendosje e sistemit të treguesve të ndarë për gra dhe burra (p.sh. përdorues transporti, ndjesia e sigurisë pas ndriçimit).

Shënjim klimatik i shpenzimeve: çfarë shkon për përshtatje dhe çfarë për ulje ndotjeje

Forcim i qasjes parandaluese: prioritarizim sipas hartës së riskut e pajisje/teknologji për paralajmërim të hershëm

Tregues ndikimi për siguri dhe akses.

Raportim vjetor për reziliencë & barazi gjinore.

ARRITJET E PROJEKTIT

"MONITORIMI I BUXHETIMIT TË NDJESHËM GJINOR DHE FINANCIMIT TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË BASHKINË SHKODËR."

P2

10 Dëgjesa Publike

ACPD mori pjesë në 10 konsultime publike, me pjesëmarrjen e 79 grave dhe vajzave. Ky angazhim dëshmon rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në proceset konsultuese publike, si dhe forcimin e kontributit të tyre në vendimarrjen vendore.

Gratë dhe vajzat ndanë rekomandime dhe kërkesa konkrete, të strukturuar sipas 7 fushave tematike prioritare: arsimi dhe infrastruktura sociale, infrastruktura rrugore, shërbimet publike, kanalet vaditëse dhe kulluese, hapësirat e gjelbra dhe rekreative, transporti publik, si dhe mbështetja e bizneseve dhe turizmit.

P4

ACPD zhvilloi **takime me Nënkryetaren** e Bashkisë Shkodër Znj. Teuta Qyteza dhe aktorë të tjerë kyç për të mbështetur integrimin e perspektivës gjinore në buxhetimin vendor.

ACPD realizoi një vlerësim të buxhetit 2024-2025 të Bashkisë Shkodër me fokus në reziliencën klimatike dhe barazinë gjinore, duke analizuar ndikimin e programeve tek përfituesit gra dhe burra dhe duke hartuar një **raport watchdog**.

